

VENDIM

Nr. 226, datë 25.2.2015

PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE FONDEVE BUXHETORE NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE, PËR VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 11 e 17, të ligjit nr.160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri organik i punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit shtohet me 30 veta dhe bëhet, gjithsej, 101 punonjës.

2. Numri organik i punonjësve të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave shtohet me 7 veta dhe bëhet, gjithsej, 2 144 punonjës.

3. Numri organik i punonjësve të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes shtohet me 8 veta dhe bëhet, gjithsej, 446 punonjës.

4. Numri organik i punonjësve të Ministrisë së Zhvillimit Urban pakësohet me 12 veta dhe bëhet, gjithsej, 790 punonjës.

5. Numri i punonjësve të Ministrisë së Mjedisit pakësohet me 7 veta dhe bëhet, gjithsej, 1 240 punonjës.

6. Numri organik i punonjësve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit pakësohet me 6 veta dhe bëhet, gjithsej, 38 285 punonjës.

7. Numri organik i punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes pakësohet me 8 veta dhe bëhet, gjithsej, 8 988 punonjës.

8. Numri organik i punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme pakësohet me 6 veta dhe bëhet, gjithsej, 14 675 punonjës.

9. Numri organik i punonjësve të Ministrisë së Punëve të Jashtme pakësohet me 1 vetë dhe bëhet, gjithsej, 506 punonjës.

10. Numri organik i punonjësve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë pakësohet me 2 veta dhe bëhet, gjithsej, 415 punonjës.

11. Numri organik i punonjësve të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë pakësohet me 2 veta dhe bëhet, gjithsej, 2 833 punonjës.

12. Numri organik i punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë pakësohet me 1 vetë dhe bëhet, gjithsej, 3 463 punonjës.

13. Njësitë strukturore të përfshira në programin “Zhvillimi i turizmit” kalojnë në varësi administrative të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

14. Njësitë strukturore të përfshira në programin “Administrimi i ujërave” kalojnë në varësi administrative të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

15. Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në buxhetin e miratuar të vitit 2015, në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, i shtohet fondi prej 25 800 000 (njëzet e pesë milionë e tetëqind mijë) lekësh, përkatësisht, 19 800 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë, në zërin “Shpenzime korrente”, dhe 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë, në zërin “Investime kapitale të brendshme”.

16. Ministrisë së Zhvillimit Urban, në buxhetin e miratuar të vitit 2015, në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, i pakësohen fondet, 19 800 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë, në zërin “Shpenzime korrente”, dhe 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë, në zërin “Investime kapitale të brendshme”.

17. Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në buxhetin e miratuar të vitit 2015, në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, i shtohet fondi prej 8 000 000 (tetë milionë) lekësh, në zërin “Shpenzime korrente”.

18. Ministrisë së Mjedisit, në buxhetin e miratuar të vitit 2015, në programin “Administrimi i ujërave”, i pakësohet fondi prej 8 000 000 (tetë milionë) lekësh, në zërin “Shpenzime korrente”.

19. Ngarkohen ministritë e përmendura në këtë vendim, që brenda muajit mars të vitit 2015, të përgatitin dhe të dërgojnë për miratim projektstrukturat e njësive strukturore, sipas numrit organik të miratuar në pikat 1-8, të këtij vendimi.

20. Ngarkohen Ministria e Financave dhe ministritë e përmendura në këtë vendim për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

